

KOMUNIKATE PER SHTYP

Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë, më datën 21 Tetor 2014, shpalli projektin që do të përfaqësojë Shqipërinë në Edicionin e 56-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit në Venecia (9 Maj – 22 Nëntor 2015) – *Albanian Trilogy: A Series of Devious Stratagems (Trilogjia Shqiptare: Një Seri Stratagjemash të Tërthortë)* nga Armando Lulaj, kuruar nga Marco Scotini.

Albanian Trilogy: A Series of Devious Stratagems përfaqëson përfundimin e një kërkimi shumë-vjeçar të artistit mbi periudhën e Luftës së Ftohtë në Shqipëri e më gjerë, rolit të së kaluarës në të tashmen, kujtesës si dhe eksperiencës historike – veçanërisht nëpërmjet arkivave, “trofeve” dhe “boshllëqeve” të së kaluarës. Vepra e parë në këtë cikël është filmi me metrazh të shkurtër *It Wears as It Grows*, kurse vepra e dyta është projekti i mirënjohur *NEVER* – që është shfaqur në një numër të konsiderueshëm ekspozitash të rëndësishme në mbarë botën. Vepra e tretë, *Recapitulation* do të prodhohet posaçërisht për Bienalen e Venecias.

Ky projekt u përzgjedh nëpërmjet një thirrjeje të hapur për projekt-propozime (21 Gusht – 30 Shtator 2014), shpallur nga Ministria e Kulturës në rolin e komisionerit të pavionit të Shqipërisë, nga një juri ndërkombëtare e përbërë nga: Boris Groys, Kathrin Rhomberg, Adrian Paci, Albert Heta dhe një përfaqësues i Ministrisë së Kulturës. Juria, vendimi i së cilës ishte unanimitet, e ka argumentuar zgjedhjen e saj si më poshtë:

Midis projekt-propozimeve tejet bindëse të paraqitura për konkursin për edicionin e ardhshëm të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit në Venecia (9 Maj – 22 Nëntor 2015), Juria vendosi unanimitet të rekomandojë projektin e Armando Lulaj, *Albanian Trilogy: A Series of Devious Stratagems (Trilogjia Shqiptare: Një Seri Stratagjemash të Tërthortë)*, kuruar nga Marco Scotini, për të përfaqësuar Republikën e Shqipërisë.

Nëpërmjet këtij projekti, Armando Lulaj ngre pyetje rreth interpretimeve ekzistuese të historisë së Shqipërisë duke filluar nga Lufta e Ftohtë e deri në ditët e sotme, duke risjellë mes nesh imazhe të një kohe tjetër, por të pasura me nënkuptime politike, si dhe narrativa ende të ngulitura në kujtesën vizuale të popullit, në një mënyrë që shkon përtej një hetimi subjektiv të historisë së një kombi drejt një analize të përgjithshme e të fuqishme të rrënojave dhe dështimeve të modernitetit.

Aftësia e Lulajt për të krijuar lidhje dhe kontekste që nuk janë menjëherë të dukshme, por që megjithatë janë bindëse, aspekti visual joshës i veprave (*Never*, *It Wears as It Grows*, dhe *Recapitulation*) si dhe i instalimit, që arrin të jetë njëkohësisht lojçak dhe monumental – një arritje e rrallë, siguron që *Albanian Trilogy: A Series of Devious Stratagems* do të arrijë të tërheqë një publik të gjerë, përveç atyre që janë të interesuar dhe të informuar rreth historisë së Shqipërisë.

ARTISTI:

ARMANDO LULAJ (1980) është një artist, dramaturg, dhe regjisor që jeton dhe punon në Tiranë, Shqipëri. Pasi u përjashtua nga Akademia e Arteve të Bukura në Firenze në vitin 2001, në vijim të aksioneve të tij të shumta që synonin çlirimin e këtij institucioni nga konformizmat teorikë e akademikë, Lulaj u diplomua pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Bolonja. Po në këtë institucion, Lulaj ndoqi edhe studimet e Masterit të Arteve të Bukura (MFA).

Disa prej ekspozitave të tij personale janë: *UNTITLED* (Bologna: Galleria Cavour, 2014); *Fiend* (Tiranë: Teatri Kombëtar, 2013); *Cold Wind* (Basel: Volta8, 2012, & Bologna: Art Fair, 2013); *No More Feelings* (Rovereto: Paolo Maria Deanesi Gallery, 2012); *No Mercy* (Milan: Artra Gallery, 2011); *Silent Soziale Corruption* (Munich: Städtische Kunsthalle München, 2010); *Time Out of Joint* (New Zealand: Te Tuhi Center for the Arts, 2007); *Mainstream Dissent* (Milan: Artra Gallery, 2006); *Temporary Autonomous Zones* (Tiranë: Insurgent Space, 2005).

Gjithashtu, Lulaj ka marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive si: *Territories* (Graz: <rotor> centre for contemporary art, 2014); *Utopian Days* (South Korea: Total Museum of Contemporary Art, 2014); *Lost in Landscape* (Rovereto: MART Museum, 2014); *Les Rencontres Internationales* (Paris: Palais de Tokyo, 2014); *The Empty Pedestal* (Bologna: Museo Civico Archeologico, 2014); *The Aesthetics of the Small Act* (Thessaloniki: Action Field Kodra, 2013); *Off Side* (Locarno: La Rada Space for Contemporary Art, 2013); 63rd Berlinale Film Festival (Berlin, 2013); 6th Berlin Biennial for Contemporary Art (Berlin, 2010); 8th Baltic Biennale of Contemporary Art (Szczecin, 2009); Italian Vision Film Festival (Bologna: Cineteca, 2007); *October. Art from the East* (Milan: Artra Gallery, 2007); 52nd Venice Biennial, Albanian Pavilion (Venice: Palazzo Malipiero, 2007); 4th Gothenburg Biennial (Gothenburg: Roda Sten, 2007); Prague Biennial 3 (Prague, 2007); *Laws of Relativity* (Torino: Fondazione Sandretto Re Rabaudengo, 2007); *Opening Hours* (Athens: Rebecca Cahmi Gallery, 2007); Onufri 06 (Tiranë: Galeria Kombëtare e Arteve, 2006); *Bunker no Bunker* (Mexico: Ramis Barquet Gallery, 2006); *AYOR. No Man's Land* (Athens: Hellenic Foundation, 2006); *Action Field Kodra* (Thessaloniki: Boundary Lines, 2006); *Mini Tirana Biennial* (New York: Apexart, 2006); Tirana Biennial 3: *Episode 1 – Temptations & Episode 3 – Democracies* (Tiranë: Galeria Kombëtare e Arteve, 2005); *Glokal* (Kosovë: Galeria Kombëtare e Kosovës, 2004); *Post-Albania* (Hamburg: Kunst Raum Gallery, 2004); Tirana Biennial 2: *U-Topos, Endurance-Transmigration* (Tiranë: Debatikcenter of Contemporary Art); Prague Biennial 1 (Prague: Wetricki Palace, 2002); *Così lontani così vicini* (Firenze: Amerigo Vespucci Airport, 2002); Onufri 02: *Small Brother* (Tiranë: Galeria Kombëtare e Arteve, 2002); *BalkanArt02* (Novi Sad: National Gallery, 2002); *Networking 1* (Siena: Magazini del Sale, 2002); *Rotte Metropolitane 3* (Firenze: Galleria Biaggiotti, 2001); *Till I Collapse* (Firenze: Gallery of Academy, 2001).

Ndër filmat e tij të shkurtër përmendim: *Living in Memory* (2004); *Problems with Relationship* (2005); *It Wears As It Grows* (2011); *NEVER* (2012). Ndër skenarët e tij përmendim: *The Tristidia Rhapsody* (2010); *Firefly* (2011); *100 Euros* (2012).

Lulaj ka marrë pjesë në rezidenca artistike pranë <rotor> (Graz, 2014), TICA – AIRLAB (Tiranë, 2012), IASPIS (Stockholm, 2010); Villa Valberta (Munich, 2009); Action Field Kodra (Thessaloniki, 2006).

KURATORI:

MARCO SCOTINI është një kurator i pavarur që jeton dhe punon në Milano, Itali. Ai është Drejtor i Departamentit të Arteve Pamore dhe Studimeve Kuratoriale pranë NABA, Milano. Scotini është Kryeredaktor i revistës *No Order: Art in a Post-Fordist Society* (Archive Books, Berlin), si dhe Drejtor i Arkivit Gianni Colombo (Milano). Së fundmi, Scotini është caktuar Drejtor Artistik i PAV në Torino për vitin 2015. Ai është një prej themeluesëve të Isola Art and Community Center në Milano.

Shkrimet e tij gjenden në periodikë të ndryshëm si: *Moscow Art Magazine*, *Springerin*, *Flash Art*, *Domus*, *Manifesta Journal*, *Kaleidoscope*, *Brumaria*, *Chto Delat?/What is to be done?*, *Open!*, *South as a State of Mind*, dhe *Alfabeta*. Gjithashtu, ai është redaktori i një libri kushtuar filmit dokumentar dhe arkivit, *Politics of Memory* (Rome: DeriveApprodi, 2014; Archive Books, 2015) me kontribute nga John Akomfrah, Eric Baudelaire, Ursula Biemann, Yervant Gianikian e Angela Ricci Lucchi, Khaled Jarrar, Lamia Joreige, Gintaras Makarevicius, Angela Melitopoulos, Deimantas Narkevicius, Lisl Ponger, Florian Schneider, Eyal Sivan, Hito Steyerl, Jean-Marie Teno, Trinh T. Minh-ha, Wendelien van Oldenborgh, Clemens von Wedemeyer, Mohanad Yaqubi.

Ndër ekspozitat e tij të fundit përmendim: projektin në vazhdim *Disobedience Archive* (Berlin, Mexico DF, Eindhoven, Karlsruhe, Nottingham, Bucharest, Riga, Zagreb, Atlanta, Boston, Umea, Copenhagen, Turin, Madrid, Istanbul 2005–2014); *Da Capo: Deimantas Narkevicius* (Zagreb: MSU, 2014); *Vegetation as a Political Agent* (Turin: PAV, 2014); *The Empty Pedestal: Ghosts from Eastern Europe* (Bologna: Archeological Museum, 2014); *A History of Irritated Material* (London: Raven Row, 2010) bashkë-kuruar me Lars Bang Larsen, si dhe *Gianni Colombo* (Turin: Castello di Rivoli, 2009), bashkë-kuruar me Carolyn Christov-Bakargiev. Momentalisht, Scotini është duke punuar mbi një ekspozitë madhore kushtuar artit nga Lindja e Mesme, *Too Early, Too Late*, për Pinacoteca Bologna, 2015.

Ai ka kuruar mbi 100 ekspozita personale ose retrospektiva për artiste si: Santiago Sierra, Deimantas Narkevicius, Jaan Toomik, Ion Grigorescu, Regina José Galindo, Gianni Motti, Anibal Lopez, Said Atabekov, Alimian Jorobaev, Vangelis Vlahos, Maria Papadimitriou, Armando Lulaj, Bert Theis, dhe shumë të tjerë. Gjatë karrierës së tij, Scotini i ka kushtuar disa ekspozita skenës artistike të Evropës Lindore, duke përfshirë: *A Sense of Wellbeing: Loss, History and Desires* (Karlovy Vary: Palace of the Imperial Thermal Baths, 2001); *Der Prozess: Collective Memory and Social History* (Prague Biennale 3, 2007); *October: Exit, Memory and Desire* (me Andris Brinkmanis, Milan, 2007); *The Empty Pedestal: Ghosts from Eastern Europe* (Bologna: Archeological Museum, 2014). Bashkëpunimi i tij me Armando Lulaj daton qysh prej vitit 2001.

JURIA:

Boris Groys është një filozof, eseist, kritik arti, teoricien i mediave, dhe ekspert i mirënjohur botërisht i letërsisë dhe artit postmodern të periudhës së vonët sovjetike, si dhe i avangardës ruse të fillim-shekullit të njëzetë. Ai është autori i shumë librave të rëndësishëm si: *The Total Art of Stalinism*, *Art Power*, *The Communist Postscript*, *Going Public*, *An Introduction to Antiphilosophy*, *On the New*, *Under Suspicion: A Phenomenology of Media*, etj. Groys ka punuar pranë shumë universiteteve prestigjioze gjatë karrierës së tij. Aktualisht, ai është Full Professor of Russian and Slavic Studies pranë New York University, New York, dhe Senior Research Fellow pranë Academy of Design, Karlsruhe, Gjermani.

Kathrin Rhomberg është një kuratore e pavarur që jeton në Vjenë. Nga viti 1990 deri në vitin 2001, ajo ishte kuratore dhe Drejtore e Ekspozitave pranë Secession, Vjenë; dhe nga viti 2002 deri në vitin 2007, Drejtore e Kölnischer Kunstverein, Kolonjë. Ajo është bashkë-themeluese (së bashku me Maria Hlavajova) e “transit”, një rrjet që mbështet shkëmbime në fushën e praktikave të artit bashkëkohor në Austri, Çeki, Hungari, Sllovaki, dhe Romani. Rhomberg ka qenë kuratore e Pavionit të Çekisë dhe Sllovakisë (*Loop*, Roman Ondák) në Edicionin e 53-të të Bienales së Venecias, 2009, dhe e Pavionit të Republikës së Kosovës (Petrit Halilaj) në Edicionin e 55-të të Bienales së Venecias, 2013. Ndër projektet e tjera kuratoriale të saj përmendim: *The Bauhaus in Calcutta – A Cosmopolitan Avant-garde Encounter*, Bauhaus Dessau, 2013 (me Regina Bittner, Partha Mitter, Boris Friedewald, dhe Sria Chatterjee); *Former West – Documents, Constellations, Prospects*, HKW, Berlin, 2012 (me Maria Hlavajova); *Christoph*

Schlingensief – Fear in the Core of Things, BAK (basis voor actuele kunst), Utrecht, dhe Galerija Novi, Zagreb, 2012; si dhe *what is waiting out there*, 6th Berlin Biennial, 2010. Aktualisht, Rhomborg është lektore pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Vjenë.

Adrian Paci (1969) studjoi pikturë pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë. Në vitin 1997, ai u shpërngul në Milano, ku jeton dhe punon sot e kësaj dite. Gjatë karrierës së tij ai ka patur shumë ekspozita personale në institucione të rëndësishme në mbarë botën si: Trondheim Kunstmuseum, Norway (2014); Röda Sten Konsthall, Göteborg (2014); MAC, Musée d'Art Contemporain de Montréal (2014); Padiglione d'Arte Contemporanea – PAC, Milan (2014); Jeu de Paume, Paris (2013); Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë (2012); Kunsthau Zurich, Zurich (2010); Bloomberg Space, London (2010); The Center for Contemporary Art – CCA, Tel Aviv (2009); Museum am Ostwall, Dortmund (2007); MoMA PS1, New York (2006) dhe Contemporary Arts Museum, Houston (2005). Ndër ekspozitat e shumta kolektive ku ai ka marrë pjesë, përmendim: Edicionin e 14 të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arkitekturës – La Biennale di Venezia (2014); Edicionin e 48 si dhe atë të 51-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit – La Biennale di Venezia (respektivisht në vitin 1999 dhe në vitin 2005); Edicionin e 15 të Sydney Biennial (2006); Edicionin e 15 të Quadriennale di Roma, ku edhe fitoi çmimin e parë (2008); si dhe në Biennale de Lyon (2009) dhe në Edicionin e 4-ët të Thessaloniki Biennial of Contemporary Art (2013).

Albert Heta (1974) është një artist, dizajner, kurator dhe menaxher arti. Veprat e tij konsistojnë më së shumti në ndërhyrje e reagime ndaj situatave e kushteve të caktuara shoqërore, apo në rishikimin e objekteve ekzistuese. Midis veprave të tij mund të përmendim *It's time to go visiting: No visa required*, një ndërhyrje publike në billboardet e British Airways në Prishtinë (2003), *Embassy of the Republic of Kosova in Cetinje, SCG* (2004), krijuar posaçërisht për Cetinje Biennial, dhe *Kosovar Pavilion Venice Biennial 2005* (2005), shpërndarë në bashkëpunim me *e-flux*, vepra të cilat nuk janë thjeshtë instalime ose akte përvetësimi, por gjithashtu akte angazhimi me mënyrën se si këto vepra u trajtuan nga kuratorët, media, klasa politike, dhe publiku. Veprat e Hetës janë shfaqur në shumë ekspozita ndërkombëtare, duke përfshirë: Apexart, New York, MARCO, Vigo, Kunsthalle Fridericianum, Kassel, Gallery Nova, Zagreb etj. Qysh prej vitit 2006, puna e tij kanalizohet edhe nëpërmjet një konteksti kolaborativ, qendrës së projekteve Stacion - Center for Contemporary Art Prishtina.

Pavijoni i Republikës së Shqipërisë mbikqyret nga Ministria e Kulturës dhe realizohet nga Ministria e Kulturës me mbështetjen e disa donatorëve dhe koleksionistëve privatë.

Komisar: Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë

Artist: Armando Lulaj

Kurator: Marco Scotini

Kohëzgjatja: 9 Maj 2015- 22 Nëntor 2015

Salla: Arsenale di Venezia

Adresa: Rruga e Kavajës, nr 1, Tiranë

Email: info@kultura.gov.al

www.kultura.gov.al